

URDHËR
Nr. 332, datë 23.12.2025

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE TË AUTORITETIT KONTRAKTOR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28, 29 dhe 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe të pikës 2, të nenit 73, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar;

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor, për kryerjen e procedurave të prokurimit/konkurimit publik, për Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, sekretarit të përgjithshëm të ministrisë, znj. Llambriola Misto.
 2. Këto kompetenca do të ushtrohen nga sekretari i përgjithshëm, menjëherë me hyrjen në fuqi të këtij urdhri.
 3. Kompetencat e deleguara në këtë urdhër mbarojnë me shfuqizimin e tij ose me pushimin e ekzistencës së organit delegates apo të deleguar.
 4. Ngarkohet sekretari i përgjithshëm, si dhe nëpunësit e aparatit të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit për zbatimin e këtij urdhri.
 5. Sekretari i përgjithshëm nuk mund të nëndelegojë këto kompetenca.
 6. Me hyrjen në fuqi të këtij urdhri shfuqizohet çdo urdhër tjetër që bie në kundërshtim me të.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
Blendi Gonxhja